



INSTITUTI I KURRIKULËS DHE I TRAJNIMIT

PROGRAMET E KURRIKULËS BËRTHAMË TË GJIMNAZIT

FUSHA: ARTE

LËNDA: HISTORIA E ARTEVE

KODI: 1.2.11.B

PROGRAMI I LËNDËS HISTORIA E ARTEVE

PËR KLASËN E 11^{-të}

TIRANË, DHJETOR 2009

Historia e arteve është një nga lëndët që përmban fusha e arteve në gjimnaz. Ajo luan një rol të rëndësishëm në edukimin dhe plotësimin e formimit kulturor të nxënësve, duke zgjeruar më tej njohuritë për artin e zhvilluar që nga lashtësia deri në Rilindje.

Programi i klasës së 11^{te} jep njohuri të përgjithshme për zhvillimin e arteve në periudha të ndryshme historike jo vetëm në Evropë, por edhe në kultura të kontinenteve të tjera, të cilat ndikuan tek njëri-tjetri dhe ndihmuan në zhvillimin e mëtejshëm të tyre.

Nxënësit do të mësojnë të dallojnë në një vepër artistike, *llojin e artit* apo *gjininë artistike, autorin, stilin e përdorur si dhe karakteristikat e periudhës* në të cilën është krijuar vepra. Përcaktimi i tyre bëhet pasi ata do të kenë njohur dhe studiuar periudhat në të cilat u zhvilluan këto arte.

Lënda e historisë së arteve iu referohet zhvillimeve historike e artistike të arteve në përgjithësi, si dhe njohjes së vlerave të gjinive të shumëllojshme. Për të arritur këtë, programi i jep mundësi nxënësit të njohë zhvillimet e arteve dhe karakteristikat e tyre në epoka të ndryshme historike. Vend të veçantë në program zënë *veprat më domethënëse* për kohën kur u zhvillua arti (art pamor, muzikë, kërcim, teatër), si dhe analiza e *stileve, teknikave apo lëndëve materiale* të përdorura për çdo vepër arti.

Një njohje dhe studim i gjerë i historisë së arteve botëror, pasuron kulturën dhe përvojën personale të nxënësve, duke i bërë ata të jenë të ndjeshëm ndaj artit dhe të respektojnë kulturat e vendeve të ndryshme.

1. SYNIMI I LËNDËS

Ky program synon të plotësojë formimin kulturor të nxënësve, me anë të njohjes së arteve, përmes veprave të ndryshme, ku do të shpjegojnë *zhvillimin historik dhe kulturor* në periudha të ndryshme, duke u ndalur në veprat dhe autorët që bënë epokë.

2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:

- të përshkruajë zhvillimin e arteve në Evropë dhe botë, në periudha dhe kontekste të ndryshme, bazuar në vlerat artistike të secilit lloj arti;
- të identifikojë përmes veprave më përfaqësuese të arteve (art pamor, muzikë, kërcim, teatër) *autorin, vendin dhe periudhën*, duke përcaktuar *përmbajtjen e veprës, gjinisë* që i përket, *stilin* etj.;
- të bëjë vlerësimin e veprave më përfaqësuese në periudha të ndryshme, nëpërmjet trajtimit historik të tyre;
- të zhvillojë aftësitë e të menduarit kritik gjatë interpretimit të këtyre veprave.

3. OBJEKTIVA SIPAS LINJAVE

36 javë x 1 orë = 36 orë

Linja 1. Historia e artit pamor

Përshkrimi i linjës. Historia e artit pamor luan një rol të rëndësishëm në edukimin e nxënësve. Nëpërmjet studimit, ata identifikojnë *vlera estetike dhe njerëzore* të artit dhe kuptojnë *ndikimin e tij në shoqëri*. Nxënësit analizojnë dhe krahasojnë, përmes një gjuhe të thjeshtë artistike, vepra të ndryshme të artit pamor; shpjegojnë karakteristikat e periudhave dhe stilet e autorëve të ndryshëm që bënë epokë, nga periudhat më të hershme deri në Rilindje.

Orë të sugjeruara: 13

Linja	Objektiva
Historia e artit pamor	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none">të përshkruajë zhvillimet në artin pamor gjatë periudhave të ndryshme historike, duke u përqendruar në veprat dhe autorët më të spikatur:<ul style="list-style-type: none">- Arti antik:<ul style="list-style-type: none">- <i>arti prehistorik,</i>- <i>arti egjiptian,</i>- <i>arti i Egjeut,</i>- <i>arti grek,</i>- <i>arti romak.</i>- Arti në mesjetë:<ul style="list-style-type: none">- kristianizmi i hershëm,- arti bizantin,- arti romanik- arti gotik.- Arti dhe traditat jashtë Evropës:<ul style="list-style-type: none">- arti indian,- arti kinez,- arti japonez.- Arti në Rilindje:<ul style="list-style-type: none">- rilindja italiane- rilindja në Evropën veriore.të dallojë lidhjen e artit dhe pasqyrimin në to të problemeve të jetës së përditshme, duke diskutuar mbi vepra të ndryshme artistike;të vlerësojë ndikimin që kanë pasur kulturat tek njëra-

	<p>tjetra, dhe rolin që kanë luajtur në historinë e artit si p.sh.: arti grek apo romak tek rilindja italiane ose të tregojë kontributin e antikitetit grek në historinë e artit etj.;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojë autorin, veprën dhe vendin ku u krijua vepra, duke nxjerrë në pah <i>karakteristikat artistike, sociale, historike të veprës</i>; • të debatojë mbi një vepër arti, duke përdorur një fjalor të thjeshtë artistik; • të zbatojë hapat që ndjekin <i>historianët dhe kritikët e artit</i> në vlerësimin e një vepre arti (përshkrimi, analiza, interpretimi, gjykimi).
--	--

Linja 2. Historia e muzikës

Përshkrimi i linjës. Kjo linjë njeh nxënësit me zhvillimin e muzikës në periudha të ndryshme historike, nga lindja e muzikës deri në periudhën e Rilindjes. Ai/ajo shpjegon *ndikimet historike, shoqërore dhe artistike* të zhvillimit të muzikës nga njëra periudhë historike në tjetrën. Përmes studimit historik të zhvillimit të muzikës, nxënësit arrijnë të dallojnë në pjesët muzikore të ofruara *stilin* dhe *elementet shprehëse* që janë tipike për një epokë, kompozitor, mjedis gjeografik.

Përmes komunikimit dhe përdorimit të një fjalori të thjeshtë muzikor, nxënësit aftësohen për të zhvilluar qëndrimet e tyre ndaj pjesëve muzikore që dëgjojnë, pavarësisht periudhës, autorit apo vendit kur dhe ku është krijuar ajo pjesë.

Orë të sugjeruara: 7

Linja	Objektiva
Historia e muzikës	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të klasifikojë zhvillimet e muzikës në periudha të ndryshme historike deri në Rilindje, duke u mbështetur në karakteristikat specifike <i>historike dhe stilistike muzikore</i> të pjesëve më të njohura muzikore gjatë periudhave të ndryshme sipas një renditje historike: <ul style="list-style-type: none"> - <i>muzika në lashtësi,</i> - <i>muzika në mesjetë,</i> - <i>muzika në Rilindje.</i> • të përcaktojë për çdo periudhë kompozitorët më të spikatur dhe veprat e tyre, duke nxjerrë në pah <i>karakteristikat muzikore të pjesës</i>; • të krahasojë vepra të së njëjtës formë muzikore duke u përqendruar në stilin muzikor të një epoke apo të një autori; • të debatojë mbi një vepër muzikore, duke e dëgjuar dhe duke përdorur gjatë dëgjimit një fjalor të thjeshtë të

Linja 3: Historia e kërcimit

Përshkrimi i linjës. Kjo linjë i njeh nxënësit me njohuri të përgjithshme të zhvillimit të kërcimit nga lindja deri në periudhën e Rilindjes, duke renditur karakteristikat e ndryshme të zhvillimit të kërcimit. Përmes studimit të kërcimit, lindjes së baletit dhe formave të tjera të kërcimit, si dhe veprave më të arrira e përfaqësuesve kryesore, nxënësit kuptojnë më mirë zhvillimin e këtij arti në kontekstin historik, shoqëror dhe kulturor.

Orë të sugjeruara: 6

Linja	Objektiva
Historia e kërcimit	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë zhvillimin e artit të kërcimit, duke analizuar <i>periudhën, veprat, zhanret</i> dhe <i>përfaqësuesit</i> më të spikatur: <ul style="list-style-type: none"> - <i>arti parahistorik</i> dhe kërcimet para lindjes së baletit si gjini, - <i>zhvillimi i kërcimit gjatë mesjetës,</i> - <i>periudha e Rilindjes lindja e baletit si gjini,</i> - <i>zhvillimi i baletit në këtë periudhë.</i> • të përcaktojë për çdo periudhë <i>koreografët</i> më të spikatur dhe <i>veprat e tyre</i>, duke nxjerrë në pah <i>karakteristikat muzikore dhe koreografike të veprës;</i> • të shpjegojë ndikimin që kanë pasur zhanret e tjera të artit në lindjen e baletit si gjini; • të përdorë kërkimin për të diskutuar rreth disa përfaqësuesve kryesorë të kërcimit; • të mbështesë interesat e nxënësve për të marrë pjesë, në veprimtari të ndryshme artistike në klasë, shkollë, mjedisin ku jeton.

Linja 4: Historia e teatrit

Përshkrimi i linjës: Përveç njohjes me etapat kryesore të zhvillimit të teatrit në periudhën nga antikiteti deri në periudhën e Rilindjes, *historia e teatrit botëror* e klasës së 11^{te} përcakton ndikimet dhe karakteristikat e tij historike, shoqërore dhe artistike në këto periudha. Paralelisht, nxënësit do të studiojnë zhvillimin e elementeve kryesore që përbëjnë teatrin, zhvillimin e dramës, të skenës, të artit të aktorit etj. Zhvillimi i linjës kërkon edhe thellimin e qëndrimit kritik nëpërmjet kryerjes së disa detyrave të thjeshta,

për shembull, analizën e disa prej veprave më të shquara dramaturgjike dhe më përfaqësuese të dramaturgjisë botërore në periudhat e lartpërmendura.

Orë të sugjeruara: 10

Linja	Objektiva
<p>Historia e teatrit</p>	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë <i>etapat kryesore</i> të zhvillimit historik të teatrit dhe të njohë <i>përfaqësuesit kryesorë të tij</i>: <ul style="list-style-type: none"> - <i>lindjen e teatrit dhe origjinën e tij,</i> - <i>lindjen e tragjedisë dhe përfaqësuesit e teatrit antik greko-romak nga shekulli i 5^{të} p.e.r e deri në shekullin e 5^{të} të e. re,</i> - <i>teatrin gjatë mesjetës nga shekulli i 5^{të} deri në shekullin e 15^{të},</i> - <i>teatrin gjatë Rilindjes në Evropë.</i> • të klasifikojë këto etapa sipas karakteristikave të tyre historike, shoqërore dhe artistike; • të analizojë disa veprat më përfaqësuese të dramaturgjisë botërore të periudhave nga antikiteti deri në periudhën e Rilindjes; • të vlerësojë zhvillimin e teatrit duke u nisur nga zhvillimi i elementeve të tjerë përbërës së tij si: <i>lloji i skenave, i artit të aktorit dhe regjisorit, teknika skenike</i> etj; • nëpërmjet realizimit të një eseje, të japë <i>një argument, opinion, mendim</i> në lidhje me realizime të ndryshme skenike të veprave dramaturgjike të periudhave që ka studiuar në këtë program; • të mbështesë interesat e nxënësve për të marrë pjesë, në veprimtari të ndryshme artistike në klasë, shkollë, mjedisin ku jeton.

5. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është një dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për lëndën e historisë së arteve. Dokumentet e tjera kryesore janë korniza kurrikulare e gjimnazit dhe standardet e fushës kurrikulare të arteve, ku kjo lëndë bën pjesë. Hartimi i programit është mbështetur te korniza kurrikulare, si dhe te standardet e fushës.

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit, është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura.

Historia e arteve në gjimnaz studiohet në klasën e 11^{te}, në 36 orë mësimore gjithsej dhe organizohet sipas linjave *art pamor, kërcim, muzikë dhe teatër*.

Përmes këtij programi nxënësit njohin, studiojnë dhe vlerësojnë periudhat në të cilat u zhvilluan *llojet* të ndryshme të artit në Evropë dhe në botë, *veprat e arteve, karakteristikat* dhe *përfaqësuesit kryesorë* në këto periudha të marra në studim. Përmes studimit ata do të jenë në gjendje të dallojnë në një vepër artistike *veprën, autorin* si dhe *periudhën* së cilës i përket vepra.

Të menduarit kritik për zhvillimin e qëndrimeve dhe vlerësimin e një vepre artistike.

Për të formuar njohuritë dhe qëndrimet artistike të nxënësve në lëndën e historisë së artit, në përshtatje me natyrën që kanë artet në përgjithësi, mësues/i,-ja duhet të zhvillojë tek nxënësit kulturën e nevojshme artistike, të domosdoshme për njohjen, evidentimin dhe studimin e veprave të autorëve më përfaqësues, duke evidentuar karakteristikat e veprave që ata kanë krijuar. Programi i historisë së arteve kërkon nga zbatuesit që kjo lëndë të mos zhvillohet vetëm në planin teorik, por të trajtohet edhe si një lëndë që përmes *detyrave individuale* apo *në grup* apo *punëve të kursit*, të zhvillojë aftësitë *analizuese, krahasuese* dhe *vlerësuese* të veprave të artit qofshin figurative, skenike, vokale etj., dhe ku çdo nxënës/e duhet të përftojë aftësitë për të mbajtur qëndrim artistik dhe kritik ndaj tyre.

Për zhvillimin e kësaj lënde, rol të rëndësishëm luan *mjedisi, metodat* dhe përdorimi i *teknologjive mësimore* (TV, video, magnetofon, CD, DVD, projektorë etj.), ndërsa për realizimin e projekteve, në varësi nga tema e tyre, kërkohet bashkëpunimi dhe puna në grup.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

Objektivat e programit

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia për të nxënë çka përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektivave në tema apo njësi, si dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit. P.sh.: objektivi i marrë nga linja e artit pamor:

- të përcaktojë *autorin, veprën* dhe *vendin* ku u krijua vepra, duke nxjerrë në pah *karakteristikat artistike, sociale, historike të veprës*;

kërkon që të gjithë nxënësit të njohin zhvillimet e artit jo duke përsëritur në mënyrë mekanike, por duke përcaktuar dhe analizuar veprat e përcaktuara *që bënë epokë, autorin, vendin ku u krijua, si dhe disa nga karakteristikat* e veprës*. Nëse një përdorues i programit nuk e bën këtë, nuk ka zbatuar programin lëndor.

Një objektivi përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm.

Mësues/i,-ja dhe autorët e materialeve mësimore duhet të mbulojnë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve.

P.sh.: objektivi: të mbajë qëndrim personal gjatë analizës që i bën zhvillimit historik të veprave të artit (p.sh.: në një debat, ese etj.), sipas disa kritereve:

* Ky shënim është i vlefshëm për të gjithë përdoruesit e programit.

- vepra,
- periudha dhe autori,
- mjedisi historik e shoqëror,
- mesazhit që përcjell vepra,
- teknikat dhe materialet e përdorura,

kërkon që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të krijojnë një qëndrim personal në mënyrë të sigurt, por jo nga të gjithë do të pretendohet i njëjti nivel i qëndrimit ndaj veprave të ndryshme artistike.

Një nivel më i lartë se ky është përdorimi i këtyre njohurive në situata të reja nga nxënës/i,-ja, pavarësisht nga kapitulli që po studion.

Orët mësimore

Programi i historisë së arteve është strukturuar në 4 linja që vijnë njëra pas tjetrës, ku sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, por janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë.

Domethënë, mësues/i,-ja mund të vendosë të vazhdojë më ngadalë kur vë re se nxënësit hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave mësimore, por mund të ecë më shpejt kur nxënësit demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Në programin e lëndës së historisë së arteve afërsisht **70%** e totalit të orëve mësimore janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore, ndërsa **30%** e tyre janë për përpunimin e njohurive (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- përsëritjen brenda një linje të caktuar të njohurive bazë të tij (njohuritë dhe konceptet themelore);
- testimin e njohurive bazë;
- integrimin e njohurive të reja të një linje me njohuritë paraardhëse p.sh.: zhvillimi i teatrit dhe i muzikës në Rilindje, karakteristikat apo ndikimet që ato patën prej njëra-tjetrës;
- integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera brenda fushës së arteve apo edhe më tej (ndonëse këto integrime do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme);
- projektin kurrikular lëndor që mund të jetë lëndor apo ndër-lëndor;
- përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja, lënda duhet parë si një e tërë).

Në orët mësimore që i përkasin përpunimit të njohurive, mësues/i,-ja zhvillon edhe tema me nismën e tij/saj ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund ta kenë pikën e nisjes nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Veçanërisht gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

1. aftësi të posaçme lëndore:

- *komunikuese*; komunikimin e saktë të njohurive, mendimeve dhe qëndrimeve rreth arteve në përgjithësi dhe veprave të ndryshme, duke përdorur një fjalor të thjeshtë artistik;
- *analizuese*; analizimin e një vepre arti, duke nxjerrë në pah karakteristikat e saj;
- *krijuese*; shkrimin e një eseje (rreth 500 fjalë), duke nxjerrë karakteristikat midis dy veprave artistike (arti pamor, muzikor, koreografik apo skenik), për të sjellë opinionin dhe qëndrimin personal;
- *krahasuese*; krahasimin e dy veprave artistike, qofshin këto muzikore, figurative, skenike apo koreografike, të realizuara nga autorë të ndryshëm, por që i përkasin të njëjtës periudhë historike.

2. *formimit të qëndrimeve*, si qëndrimi etiko-social etj. dhe qëndrimi gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike, bazuar mbi një tematikë të caktuar etj.

Me nxënësit me vështirësi në të nxënë, duhet të punohet veçmas për realizimin e detyrave, duke iu përshtatur stileve të tyre të të nxënit.

6. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënës/it,-es përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënës/it,-es nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj. Gjithashtu, vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat mësimore, programin lëndor dhe mësues/i,-ja nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët.

Mësues/i,-ja zhvillon vetë dhe në bashkëpunim me nxënësit, një larmi mënyrash vlerësimi, që kanë të bëjnë me:

- përdorimin e saktë të *njohurive mbi 4 fushat e arteve*;
- dallimin e individit (nxënës/it,-es) më të suksesshëm gjatë debatit për krahasimin e dy veprave të artit botëror (art pamor, muzikë, teatër apo kërcim);
- shkrimin e esesë (rreth 500 fjalë) duke përcjellë saktë qëndrimin e vet rreth një shfaqjeje artistike si dhe duke përcjellë emocionet e veta rreth skenës, veshjeve, muzikës, interpretuesve etj.;
- vlerësimin përfundimtar të një punimi kursi për krijimin e një posterit: ku të veçojnë piktorin/aktorin/kompozitorin/regjisorin apo balerinin e preferuar; CD: ku të sjellë muzikën e preferuar; album me vepra arti 2 – 3 dimensionale etj.;
- evidentimi i individit (nxënës/it,-es), për kërkimin dhe prurjen e informacioneve të sakta dhe në koherencë me detyrën e kërkuar.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj.

Mësues/i,-ja nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore, por për punë të paracaktuara të nxënësve me grupe të vogla, mësues/i,-ja

parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi apo edhe të çdo nxënësi/e në veçanti.

Si rregull, nxënësit dhe mësues/i,-ja duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara të orëve të kaluara dhe mirëkryerjes së detyrave jashtë klase. Herë pas here mësues/i,-ja duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Portofoli i nxënës/it,-es, është një mundësi tjetër vlerësimi e vetëvlerësimi, si dhe një koleksion i punimeve të nxënësve përgjatë vitit shkollor. Ai/ajo mund të përmbajë detyra të ndryshme tematike, të gjitha në dobi të veprimtarive të ndryshme shkollore, produkte të veprimtarive kurrikulare etj. Ato mund të jenë:

- ese,
- foto nga vepra apo artistë të ndryshëm,
- Cd apo DVD nga vepra të ndryshme artistike, vokale, koreografike, teatrale apo figurative,
- albume të ndryshme,
- etj.

Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësues/i,-ja rekomandon.